



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

MINISTRIA E ARSIMIT  
SPORTIT DHE RINISË

**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR**

Nr. 26/1 Prot.

Tiranë, më. 08.07.2020

### **Njoftim për bashkëpunëtorë**

Fuqizimi i shkollës dhe komunitetit për sigurimin e një mjedisi edukativ për fëmijët me aftësi të kufizuara në Shqipëri

Në kuadër të projektit “Fuqizimi i shkollës dhe komunitetit për sigurimin e një mjedisi edukativ për fëmijët me aftësi të kufizuara”, i mbështetur nga Programi i Përbashkët i Kombeve të Bashkuara “Askush të mos mbetet pas/Leave No One Behind” në partneritet me Agjencinë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP) kërkon bashkëpunëtorë të jashtëm.

Bashkëpunëtorët duhet të plotësojnë këto kërkesa:

1. Të kenë mbaruar arsimin e lartë.
2. Të kenë përvojë paraprake në punën për analizën, vlerësimin dhe zhvillimin e veprimtarive mësimore në arsimin parashkollor dhe në arsimin bazë dhe në veçanti në punën me fëmijë me aftësi të kufizuara.
3. Të kenë marrë pjesë në projekte dhe veprimtari që lidhen me zhvillimin profesional të mësuesve (përgatitje e materialeve për trajnimin e mësuesve, zhvillim i trajnimeve etj.)
4. Të kenë aftësi bashkëpunuese dhe aftësi të punës në grup.
5. Preferohen përfshirjet afatgjata në fushat e mësipërme të veprimtarive.
6. Preferohet zotërimi i gjuhës angleze.

Kandidatët duhet të dorëzojnë CV-në dhe këto dokumente (fotokopje e diplomës së shkollës së lartë, të dokumentit të identitetit) pranë sekretarisë së Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP) , brenda datës 15.07.2020, ora 16.30.

***Faleminderit!***